



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 413/1 Prot

Tiranë, më 20.12 2012

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, “**Qendra Shëndetësore Nr. 1**”,
Tiranë, me adresë : “Bulevardi Marsel Kasha, Ura e Tabakëve” Tiranë

VENDIM

Nr. 02, datë 20/02/12 2011

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit *Qendra Shëndetësore Nr. 1, Tiranë*,

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji.

Në zbatim të Urdhërit nr.13, datë 02.02.2012 pranë kontrolluesit *Qendra Shëndetësore Nr. 1, Tiranë*, është realizuar kontrolli administrativ nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe konkretisht:

Objekti i kontrollit ishte:

- **Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit të Komisionerit Nr. 20, datë 08.10.2010, dhënë ndaj kontrolluesit “Qendra Shëndetësore Nr. 1, Tiranë”, në lidhje me:**
- ✚ Verifikimin nëse kontrolluesi ka garantuar sigurinë fizike të dokumentave që përmbajnë të dhëna personale (sipas pikës 1 të këtij Rekomandimi);

Në lidhje me sigurinë fizike të dokumentacionit nga grupi i kontrollit u verifikua se, janë marrë pjesërisht masa për sigurinë fizike, kishte akses të kufizuar në dokumentacion, procedura se si mbrohej informacioni është sqaruar edhe një një procesverbal të mbajtur me

mjekën e familjes Zj. Edlira Lashi, datë 07.02.2012(i dorëzuar në cilësinë e dokumentacionit në dosje). Ndërkohë me ekonomistën Zj. Denada Cami është mbajtur një procesverbal i dytë ku ekonomistja na informoi se është investuar në lidhje me sigurinë fizike me blerjen e disa kartotekave të reja, e vërtetuar kjo nëpërmjet fletëhyrjes nr, 09, datë 14.11.2011(e tërhequr në cilësinë e provës)

Siguria fizike e objektit, garantohet me anë të një kontrate të lidhur me SHRSF “Trezhnjeva”. Kjo kontratë është e depozituar në dosje në cilësinë e provës, nga grupi i kontrollit. Ndërkohë, përgjigjet e analizave ende nuk janë të mbyllura në zarfe për të garantuar konfidencialitetin.

✚ Verifikimin nëse kontrolluesi ka përcaktuar dhe zbaton një afat kohor për mbajtjen e të dhënave në raport me qëllimin për të cilin janë mbledhur (sipas pikës 3 të këtij Rekomandimi).

Në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave personale, në kuptim të Nenit 5 pika “d” të Ligjit “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”, 1. *Mbrojtja e të dhënave personale bazohet: d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej*”, kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave ishte ende e pacaktuar, sidomos në lidhje me dosjet e personelit. Nuk ka rregulla dhe procedura të qarta për shkatërrimin e dokumentacionit. Kurse mbajtja e dokumentacionit për pacientët kjo ishte e domosdoshme dhe bëhej për qëllim evidentimi të vazhdimësisë së gjëndjes shëndetësore të pacientëve.

Përfundimisht, ligjërisht vlerësoj se shkeljeve administrative të konstatuara, janë si më poshtë:

- 1 Nuk është hartuar rregullorja “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” ;
- 2 Përgjigjet e analizave nuk janë të pajisura me zarfe, për të garantuar konfidencialitetin;
- 3 Janë marrë pjesërisht masa në lidhje me sigurinë fizike, me anë të investimit në kartoteka të reja;
- 4 Nuk ka afate kohore të mirëpërcaktuara për ruajtjen e dokumentacionit

Rekomandimi me nr.20, datë 08.10.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i është bërë me dije dhe ASHR-së (Autoritetit Shëndetësor Rajonal), prej nga ka dhe varësinë institucionale kjo qëndër.

Rekomandimet e Komisionerit janë të detyrueshme për tu zbatuar nga kontrolluesit të cilëve ju drejtohen. Rekomandimi që del nga Autoriteti i Komisionerit është një prej formave, që u vjen në ndihmë kontrolluesve për t'i vënë në dijeni në lidhje me detyrimet e papërmbyshura nga ana e tyre në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Sipas nenit 30 pika 2, të ligjit“ *Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*”.

Mospërmbyshja e këtij detyrimi ligjor, ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ku parashikohet dënimi me gjobë në masën nga 10.000 deri në 15.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nisur sa më sipër, në zbatim të nenit 27, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, neneve 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”:

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, *Qendra Shëndetësore Nr. 1, Tiranë*, me gjobë **15.000 (pesëmbëdhjetëmijë)** lekë.
2. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot më datë, 17.02.2012.

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (Pogaçe)

